



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/56

Datë: 18.02.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 shkurt 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkriptet nga mbledhjet 54 dhe 55 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/56
Datë: 18.02.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, si dhe nenit 12.6, i Ligjit 2004/48, i ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-071, "Për Administratën Tatimore dhe Procedurat", me qëllim të fillimit të zbatimit të regjistruesve fiskal të parave në të gatshme (cash), në ndërmarrjet afariste në Kosovë, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 shkurt 2009, mori


V E N D I M

1. Miratohet propozimi për zbatimin e regjistruesve fiskal të parave të gatshme (cash), në territorin e Republikës së Kosovës. Procesi i zbatimit duhet të fillojë deri më 1 korrik 2009.
2. Ministri i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, është i autorizuar të nxjerrë akt nënligjor, i cili përkufizon sa vijon :
 - 1) Ndërmarrjet afariste që kërkohet të vendosin regjistruesit fiskal të pagesave në para të gatshme (cash);
 - 2) Datën kur bizneset kërkohet të fillojnë përdorimin e regjistruesve fiskal të pagesave në të gatshme (cash);
 - 3) Nëse gjykohet e nevojshme, hartimi i një plani i cili përcakton rendin me të cilin do të instalohen dhe zbatohen regjistruesit fiskal të pagesave të gatshme (cash);
 - 4) Specifikimet teknike të cilat duhet t'i plotësojnë regjistruesit fiskal të pagesave në të gatshme (cash), përfshirë kohëzgjatjen gjatë së cilës regjistruesit duhet të funksionojë gjatë ndërprerjes së rrymës;
 - 5) Specifikimet teknike dhe të shfrytëzimit, që lidhen kategoritë e regjistruesve fiskal të cilat do të autorizohen, përfshirë regjistruesit fiskal të

pagesave në të gatshme (cash) portabël, të fiksuara; regjistruet fiks jo-portabël; dhe pajisje tjera të pikave të shitjes të cilat do të miratohen për përdorim në regjistrimin elektronik të transaksioneve të shitjeve;

- 6) Procedurat që duhet ndjekur në rast të humbjes së të dhënave që rezultojnë nga ndërprerja e rrymës apo rrethanave tjera të jashtëzakonshme;
- 7) Procedurat që duhet ndjekur për regjistrim manual të shitjeve në rast të një ndërprerjeje të rrymës me pasoja të rënda që dëmton regjistruet fiskal të pagesave në të gatshme (cash);
- 8) Specifikimet teknike për memorien fiskale të cilat duhet të instalohen në secilin regjistruet fiskal të pagesave në të gatshme (cash), ashtu që të dhënat e para-përkufizuara të ruhen në një memorie me pamundësi qasje dhe të pandryshueshme, të cilat janë të pashlyeshme, të plumbuara dhe janë të vendosura në një hapësirë brenda regjistruet fiskal të pagesave në të gatshme (cash) të cilat mund të riparohen apo modifikohen vetëm nga personat e autorizuar, nga Ministri i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës;
- 9) Specifikimet teknike për memorien operationale e cila duhet të instalohet në secilin regjistruet fiskal të pagesave në të gatshme (cash);
- 10) Të dhënat dhe formati i të dhënave që duhet t'i regjistrojnë regjistruet fiskal të pagesave në të gatshme (cash);
- 11) Të dhënat dhe formati i të dhënave që duhet të shtypen nga regjistruet fiskal të pagesave në të gatshme (cash), përfshirë llojin e logos tatimore sikurse është specifikuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, pas konsultimit me Ministrin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave;
- 12) Specifikimet teknike për softuerin i cili duhet të përdoret nga regjistruet fiskal të pagesave në të gatshme (cash);
- 13) Metodën me të cilën informatat e ruajtura në memorien fiskale do t'i jepen Administratës Tatimore (përmes lidhjes së drejtpërdrejtë on-line me Administratën Tatimore, apo forma tjera);
- 14) Nëse një lidhje on-line do të përdoret për transmetimin e të dhënave në Administratën Tatimore, metodën me të cilën të dhënat e tilla do të transmetohen, shpeshësinë me të cilën të dhënat e tilla do të transmetohen, të dhënat e veçanta që duhet të transmetohen dhe kërkesat tjera të aplikueshme;
- 15) Procesi i cili kërkohet të sigurojë se janë instaluar vetëm regjistruet e autorizuar fiskal të pagesave në të gatshme (cash);

- 16) Procesin përmes të cilit prodhuesit apo shpërndarësit e regjistrueseve fiskal të pagesave në të gatshme (cash), marrin certifikatën nga Administrata Tatimore për modelet e makinave të cilat plotësojnë specifikimet teknike të vendosura;
 - 17) Procesin e nevojshëm për riparimin apo mirëmbajtjen e regjistrueseve fiskal të pagesave në të gatshme (cash);
 - 18) Procedurat që duhet përdorur nga partnerët e mundshëm implementues për të shprehur interesin e tyre për të marrë pjesë me Administratën Tatimore si një partner implementues. Ministria e Ekonomisë dhe Financave, në bashkërendim me Administratën Tatimore, përcakton se shfrytëzimi i një apo më shumë partnerëve implementues është i nevojshëm për zbatimin e regjistrueseve fiskal të pagesave në të gatshme (cash);
 - 19) Kërkesat teknike dhe fiskale që duhet të plotësohen nga partnerët e mundshëm implementues;
 - 20) Procedurën që duhet ndjekur, përveç kërkesave të prokurimit të cilat tashmë janë vendosur në Ligjin e Prokurimit në Kosovë, në përzgjedhjen e një apo më shumë partnerëve implementues; dhe
 - 21) Çdo procedurë, specifikacion teknik, apo hollësi tjetër e nevojshme për zbatimin e efektshëm të këtij vendimi.
3. Akti nënligjor, sipas pikës 2. të këtij vendimi, duhet të nxirret deri më 1 qershor 2009.
 4. Obligohet Ministria e Ekonomisë dhe Financave – Administrata Tatimore e Kosovës, që brenda këtij afati të ofrojë procedurat përmbaruese të qarta.
 5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/56

Datë: 18.02.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 shkurt 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Komisionit Qeveritar për Demarkacion të Kufirit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 279.276,00 Euro, për vazhdimin e punëve në vitin 2009.
2. Mjetet financiare, nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga fondi "Rezervat e Paparashikuara" të Qeverisë, dhe barten në Zyrën e Kryeministrit, kodi 10710 në kategorinë mallra dhe shërbime.
3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/56
Datë: 18.02.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 shkurt 2009, mori

V E N D I M

1. Ndahen mjetet financiare në shumë prej 360.000,00 (treqind e gjashtëdhjetëmijë) Euro, për pagesën e qirasë për banim, për vitin 2009, në shumën nga 100 € për familje, të cilat janë të zhvendosura nga pronat e tyre në pjesën veriore të qytetit të Mitrovicës.
2. Mjetet financiare të përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi, ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara kodi 232, në kategorinë "Subvencione dhe Transfere" të Kuvendit Komunal në Mitrovicë kodi 642, në Programin e Administratës dhe Personelit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Kuvendi Komunal në Mitrovicë dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Hashim THAÇI

Kryeministri i Kosovës

Iu dërgohet:

- Të gjitha ministrive(ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/56
Datë: 18.02.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 42 të Ligjit Nr. 03/L-87, "Për Ndërmarrjet Publike", si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 shkurt 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Bordit të Drejtorëve të Postës dhe Telekomit të Kosovës mbi mundësinë e zgjerimit të veprimtarisë së saj edhe në tregun e Shqipërisë - pjesëmarrjen në tenderin për licencën e katërt të telefonisë mobile në Shqipëri.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THACI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/56

Datë: 18.02.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 42 të Ligjit Nr. 03/L-87, " Për Ndërmarrjet Publike", si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 shkurt 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet Udhëzimi Administrativ për mënyrën e përfaqësimit të komunave në bordet e drejtorëve të ndërmarrjeve publike lokale.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe kuvendet komunale.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/56
Datë: 18.02.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 20 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 03/L-87, "Për Ndërmarrjet Publike", si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 shkurt 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet rregullat mbi lartësinë e kompensimit të anëtarëve të bordeve të ndërmarrjeve publike qendrore sipas këtij kategorizimi:

Kategoria 1: Posta dhe Telekomuni i Kosovës, Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës dhe Korporata Energjetike e Kosovës.

Kategoria 2: Hekurudhat e Kosovës dhe Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut.

Kategoria 3: Ndërmarrjet tjera në sektorin e ujit, ujitjes dhe hedhurinave
(nuk përfshihen ndërmarrjet publike lokale)

2. Pagesa e anëtarëve të bordeve do të bëhet sipas tabelës 1. bashkangjitur këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

Tabela 1. Skema e kompensimit për anëtarët e bordeve të drejtorëve të Ndërmarrjeve Publike Qendrore.

Kategoria	Pozicioni	Bordi i Drejtorëve	Komisioni i Auditimit	Komitetet e tjera
		Kompensimi maksimal mujor	Kompensimi maksimal mujor	Kompensimi maksimal mujor
Kategoria 1	Kryesues	850	200	250
	Anëtar	750	150	210
Kategoria 2	Kryesues	500	150	130
	Anëtar	400	120	110
Kategoria 3	Kryesues	320	120	110
	Anëtar	270	100	95

Pagat mujore të anëtarëve të bordeve do të aplikohet në formë paushall, për takimin e Bordit. Sipas nevojës mund të ketë edhe takime shtesë, por nuk mund të tejkalohet shuma e kompensimit maksimal mujor.